



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 11820 / prot. datë 24.09.2013
3

Nr. 4757 / prot. datë 20.09.2013

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 51, datë 20.09.2013

P Ë R

"PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TE SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar", të ndryshuar, të vendimit nr. 843, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)", të ndryshuar si dhe të vendimit nr. 9, datë 4.1.2013 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimit të teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të arsimit profesional, nxënësit e pakicave kombëtare dhe nxënësit shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë",

UDHËZOJMË:

Përdorimin e fondeve buxhetore miratuar nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit (MAS) për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe ndjekja e procedurave janë sa vijon:

I. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar:

1. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, realizohet nga shtëpitë botuese dhe Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM).

2. **Certifikimi i teksteve.** Tekstet shkollore përpara se të shpërndahen ose të dalin për shitje duhet të jenë të certifikuara, me certifikatën e lejes për të hyrë në tregun e shitjes, si dhe të pajisura me pullën me hologram nga MASH.

3. **Pullat me hologram** u shiten botuesve kundrejt kostos së blerjes nga MAS. Të ardhurat e realizuara nga shitja e pullës me hologram derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM) pajiset me pulla me hologram falas pa pagesë.

II. Procedurat për përzgjedhjen dhe porosinë e teksteve të botuesi për vitin shkollor 2013-2014:

1. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet për miratim në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në Urdhrin nr.84, datë. 26.2.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës

“Për miratimin e paketës informuese “Alertekst 2013”. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre në shkolla ose në njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), përballohen/mbulohen nga shtëpitë botuese.

2. Porosia e teksteve të botuesit për vitin shkollor 2013-2014: Çdo drejtor shkolle me anë të një kërkesë-porosi, bën porosinë të botuesit për tekstet e nxënësve të shkollës. Në kërkesë-porosi, parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur të cilët figurojnë në katalogun e dërguar nga MASH për vitin shkollor 2013-2014. Porosia për tekste duhet të përfshijë/parashikojë të gjithë nxënësit e arsimit bazë dhe nxënësit e shkollave të mesme. Një kopje e kësaj kërkesë-porosi i dërgohet DAR/ZA-së.

2.1 Porosia e teksteve të pakicave kombëtare klasa e I-rë deri IX-të dhe nxënësve që ndjekin arsimin profesional: Çdo drejtor shkolle me anë të një kërkesë-porosi, bën porosinë për tekstet e nxënësve të shkollës pranë Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM) dhe shtëpive të tjera botuese, vetëm për tekstet të cilat nuk sigurohen nga BOTEM. Në kërkesë-porosi, parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur të cilët figurojnë në katalogun e dërguar nga MASH. Porosia për tekste duhet të përfshijë/parashikojë të gjithë nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar e specifikuar për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare klasa e I-rë deri IX-të dhe nxënësit e arsimit profesional. Një kopje të kësaj kërkesë-porosi i dërgohet DAR/ZA.

2.2 Porosia e teksteve të fëmijëve/nxënësve të familjeve shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë: Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me selitë diplomatike në këto vende, dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës **brenda muajit Maj** të çdo viti, kërkesën për tekste shkollore, të detajuar sipas grupmohave të fëmijëve të familjeve shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës **brenda muajit Gusht** të çdo viti, dërgon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sasinë e teksteve shkollore të porositura. Për fëmijët e familjeve shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë, sigurimi i teksteve realizohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM), në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 843, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)”, të ndryshuar.

2.3 Porosia e teksteve të fëmijëve të romë nga klasa e I-rë deri në klasën e IX, Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës romë, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, **brenda muajit Mars** të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie, për çdo klasë të vitit pasardhës shkollor.

2.4 Porosia e teksteve për nxënësit që gëzojnë statusin e të verbrit, të cilët mësojnë në klasat e I-rë deri IX-të, pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin brail, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar. Këto tekste shkollore janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre mund të variojë nga dy deri në tre vjet. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në brail dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohet nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, **brenda muajit Mars** të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie, për çdo klasë të vitit pasardhës shkollor.

III. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore, për tekstet shkollore të arsimit bazë, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional.

1. Shtëpitë botuese i shesin tekstet e certifikuar në mjediset shkollore. Drejtorët e shkollave u ofrojnë një ose dy mjedise shtëpive botuese për shitjen e teksteve. Shitja realizohet nga vetë shtëpitë botuese ose nënkontraktorët e tyre. Çmimi i shitjes duhet të jetë **jo më i lartë** sesa çmimi, me të cilin janë paraqitur dhe miratuar tekstet e certifikuar.

Për tekstet e arsimit profesional, tekstet e nxënësve të pakicave kombëtare dhe tekstet shkollore të nxënësve shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë që botohen dhe shiten nga Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM), çmimet e shitjes janë miratuar me Vendimin nr. 9, datë 4.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimit të teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të arsimit profesional, nxënësit e pakicave kombëtare dhe nxënësit shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë”.

2. Botuesit duhet të lëshojnë për çdo blerës/nxënës/prind/institucion arsimor (shkollë) faturën tatimore të shitjes sipas Formularit E –TBV 055/a dhe Formularit E –TVS 055/a të miratuara me udhëzim të Ministrisë të Financave.

3. Vlera e fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2013 do të përdoret nga nxënësi/përdoruesi/prindi/institucioni arsimor (shkolla), për të përballuar vlerën e blerjes së teksteve shkollore dhe masës së caktuar si “*transfertë tek individët*” nga buxheti i shtetit.

4. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, janë si më poshtë vijon:

4.1 për nxënësit në arsimin parauniversitar që:

- a) gëzojnë statusin ligjor të jetimit;
- b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;
- c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;
- ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;
- d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **në masën 100 për qind të tij.**

4.2 Për nxënësit në arsimin 9-vjeçar, që vijnë nga familje ku kryefamiljari është i punësuar në institucionet publike buxhetore dhe jobuxhetore të pushtetit qendror apo vendor, si dhe në shoqëritë me kapital shtetëror, me pagë mujore bruto deri 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat, çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i vetë institucionit apo shoqërisë, **në masën 50 për qind të tij.**

4.3 Të gjithë punëdhënësit privatë që mbështesin financiarisht kompensimin e teksteve shkollore për të gjithë punëmarrësit e tyre, që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë pagë mesatare mujore deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj. Kjo pagesë njihet si shpenzim i veprimtarisë për efekte fiskale.

4.4 Për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes do të mbulohet në masën 100 për qind me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4.5 Për tekstet shkollore të fëmijëve / nxënësve shqiptarë që jetojnë e arsimohen në diasporë, çmimi i blerjes së këtyre teksteve mbulohet 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4.6 Për tekstet shkollore të nxënësve/fëmijëve romë, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre mbulohet 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4.7 Për tekstet shkollore të nxënësve që gëzojnë statusin e të verbërve, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre mbulohet 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

5. Për kategoritë e nxënësve që përfitojnë sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të DAR/ZA-ve, me fondet e miratuara si “Transfertë tek individët” në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

6. Nxënësit/prindërit/institucioni arsimor (shkolla) pas blerjes së teksteve shkollore, dorëzojnë në drejtorinë e institucionit arsimor/shkollës përkatës faturat tatimore të blerjes. Drejtoria e shkollës për nxënësit që përfshihen në pikën 4.1, deri 4.7, mbështetur në dokumentacionin që vërteton statusin/gjendjen sipas vendimeve të njësive vendore (Këshillit të bashkisë apo Komunës) për gjendjen ekonomike/familjare, harton listat për çdo klasë dhe për të gjithë shkollën dhe brenda **datës 30 Shtator** i dërgon ato në DAR/ZA, në formë zyrtare dhe elektronike. (sipas formularit nr. 1 dhe formularit 1.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij).

DAR/ZA brenda datës **10 Tetor** dërgon në MAS kërkesën për fonde buxhetore të detajuar sipas niveleve arsimore/buxhetore, për arsimin bazë Gr.11, titulli 09120, për arsimin e mesëm të përgjithshëm titulli 09230, si dhe arsimin profesional titulli 09240 në kapitullin 1, artikullin 602-606.

7. MAS-i çel fondet e miratuara, për vitin 2013, i kalon ato në llogari të Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR), Zyrave Arsimore (ZA) pranë degëve të thesarit në rrethe. DAR dhe ZA menjëherë pas marrjes së njoftimit nga MAS, për çeljen e fondeve në artikullin 602-606, paraqesin pranë degëve të thesarit dokumentacionin justifikues mbi bazën e të cilit bëjnë kalimin/xhirimin e fondeve, për llogari të përfituesit nxënësit/prindit ose **shtëpive botuese** në bankat e nivelit të dytë ose zyrat e postës shqiptare.

Raportimi i fondeve të përfituara nga nxënësit/prindërit.

8. DAR/ZA brenda datës **1 Prill**, mbështetur në aktet e rakordimit me bankat e nivelit të dytë apo me zyrat e Postës Shqiptare për gjendjen faktike të përdorimit të fondeve buxhetore të kaluara për llogari të përfituesve nxënësve/prindërve, realizojnë menjëherë urdhër-xhirimin ose urdhër-pagesën për rikthimin e fondeve të papërdorura në buxhetin e shtetit, si dhe raportojnë në MAS sipas formularit nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

IV. Të përgjithshme.

1. Tekstet shkollore që blihen në tregun e lirë, pa faturë tatimore sipas Formularit E –TBV 055/a dhe Formularit E –TVS 055/a, të miratuara nga Ministri i Financave, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, prindi apo nxënësi, drejtorja e shkollës nuk mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit.

2. Tekstet shkollore që tregtohen pa pullën e certifikimit i nënshtrohen procesit të konfiskimit në përputhje me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Të gjitha tekstet shkollore që janë gjendje në magazinat e DAR dhe ZA, si dhe kanë vlerë përdorimi, të shiten me çmimet e miratuara për vitin shkollor 2006-2007.

Nxënësit/prindërit të paguajnë 50% të çmimit të miratuar të shitjes së teksteve.

Të ardhurat që do të rezultojnë nga shitja e teksteve gjendje në magazinë do të derdhen nga çdo DAR dhe ZA për llogari të:

Aparatit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

Degës së Thesarit Tiranë

Raiffesen BANK Tiranë

Numri i Logarisë për të ardhurat 010 403 0780

IBAN kod AL 222 0211 0130 0000 0010 4030 780

Në llogarinë 466 “Mjete në ruajtje, të ardhura nga shitja e teksteve shkollore për vitin shkollor 2013”.

Pas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë këto të ardhura derdhen menjëherë në buxhetin e shtetit.

4. Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.11, datë 11.7.2012 “Për procedurat e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”, shfuqizohet.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI I FINANCEVE

SHKËLQIM CANI



MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA



Formulari nr. 1;
Kërkesë e Shkollës _____ **drejtuar DAR/ZA, për mbështetje me fonde**
buxhetore, "transferte tek individët"/ për nxënësit/përfituesit/blerësit në arsimin baze,

Nr	Emri mbiemri/nxenesit/prinderit	Emri/Shkolles	Klasa 1-9të	Statusi sipas pikës 6 të VKM mbështetur në vendimin e Njësisë së pushteti vendor, apo sipas pikës, (a), (b), (c), (ç) dhe (d)	Fatura nr. Date	Sasia teksteve te blera/copë	Shuma e paguar nga prind/nxenesi në lekë	Shuma per tu paguar si Transf Individet 100%, në lekë	Numri i llogarisë bankare /ose numri i mandat-pagesës lëshuar nga zyra e postes shqiptare	Dokumenti i identiteti për prinderin që tërheq "transferte tek individit"	Emri Mbiemri, Neshkrimi për prinderin që tërheq "transferte tek individit"/
1	2	3	4		5	6	7		9	10	11
1	Ermal Dritan Peto	Delvine	I-rë	Pikës a	15/01.9.2012	5	1800	1800		Plotesohet ditën kur terhiqen leket	Plotesohet ditën kur terhiqen leket
2	Denisa Paskal Naçe	Delvine	I-rë	Pikës b	26/3.9.2012	5	1800	1800			
	Delvine	I-rë	Etj			
25	Orion Sokol Vrapit	Delvine	I-rë		8/02.9.2012	4	1500	1500			
			
							Totali	5100	5100		

Formulari nr. 1.1
Kërkesë e Shkollës _____ **drejtuar DAR/ZA, për mbështetje me fonde buxhetore "transferte tek individët"/ për**
nxënësit/përfituesit/blerësit në "Arsimin e Mesëm"

Nr	Emri mbiemri/nxenesit/prinderit	Emri/Shkolles	Klasa 10-12të	Statusi sipas pikës 6 të VKM mbështetur në vendimin e Njësisë së pushteti vendor, apo sipas pikës, (a), (b), (c), (ç) dhe (d)	Fatura nr. Date	Sasia teksteve te blera/copë	Shuma e paguar nga prind/nxenesi në lekë	Shumna per tu paguar si Transf Individeton 100%, në lekë	Numri i llogarisë bankare /ose numri i mandat-pagesës lëshuar nga zyra e postes shqiptare	Dokumenti i identiteti për prinderin që tërheq "transferte tek individit"	Emri Mbiemri, Neshkrimi për prinderin që tërheq "transferte tek individit"/
1	2	3	4		5	6	7		9	10	11
1	Andri Erjon Pano	Delvine	X-të	Pikës a	15/01.9.2012	10	3500	3500	Zyra Postare Delvine	Plotesohet ditën kur terhiqen leket	Emri Mbiemri, neshkrimi Plotesohet ditën kur terhiqen leket
2	Sokol Pirro Duro	Delvine	X-të	Pikës b	26/3.9.2012	11	3700	3700			
	Delvine	X-të	Etj			
25	Anisa Niko Duro	Delvine	X-të		8/02.9.2012	12	3800	3800			
			
							Totali	11000	11000		

Formulari nr. 2;
Kërkesë e DAR/ZA _____ **drejtuar MAS, për mbështetje me fonde buxhetore "transferte tek individët"/ për**
nxënësit/përfituesit/shkollën; _____ **Në Arsimi 9vjeçar /Arsimin e Mesëm/Arsimin Profesional**

Nr.	Institucioni	Numri i nxenesveve Klasa I-re që perfitojne kompesim	Numri i nxenesveve Klasa II-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa III-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa IV-ter, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa V-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa VI-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa VII-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa VIII-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nx Klasa IX-te, që perfitojne kompesim	Nr. Nxe Total Kl I- IX	Fondi i kompesimit kerkuar ne MAS ne leke
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Shkolla A											
2	Shkolla B											
...											
25	Shkolla Z						
	Totali											

Formulari nr. 3;

Akt rakordimi i mbajtur në datën _____ në Bankën e nivelit të dytë _____
/ Zyrën e Postës Shqiptare _____ në datën _____

Nr.	Institucioni	Programi arsimor (arsimi bazë, arsimi i mesëm, arsimi Profesional)	Numri i nxenesve që perfitojnë kompesim (Arsimi Baze) Klasa I-re deri në klasën IX	Fondi kompesimit xhiruar në Banke/ Zyren e Postës Shqiptare	Numri i nxenesve nga Klasa I-re deri në klasën IX që kanë terhequr kompesim	Fondi kompesimit i terhequr nga familja/ xhiruar për llogari të tyre në Banke/ Zyren e Postës Shqiptare	Numri i nxenesve nga Klasa I-re deri në klasën IX që nuk kanë terhequr kompesim	Fondi i kompesimit i paterhequr nga familja/ apo i paxhiruar xhiruar për llogari të tyre në Banke/ Zyren e Postës Shqiptare	Vërejtje/ shenime
1	2	3	4	5	6	7=3-5	8=4-6	12	13
1	Shkolla A	09120							
2	Shkolla B	09120							
...								
25	Shkolla Z	9120			
	A -Shuma 09120								
1	Gjimnazi A	09230							
2	Gjimnazi B	09230							
...								
25	Gjimnazi Z	09230			
	B- Shuma 09230								
1	Shkolla e Mesme Profesionale A	09240							
2	Shkolla e Mesme Profesionale	09240							
...								
25	Shkolla e Mesme Profesionale Z	09240			
	C- shuma 09240								
	Totali A+B+C								

Shënim: Bashkëlidhur këtij akt rakordimi, janë fotokopje të listpagesave të nxënësve/ prindërve përfitues, të realizuara nëpërmjet Bankave të Nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, të nëshkruara nga prindërit përfitues.

